

FJALA E DEPUTETES LINDITA METALIAJ

E ENJTE 24 SHKURT 2022

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë, që po ndiqni këtë seancë,

Sot u zgjuam të gjithë me një lajm të trishtë e të dhimbshëm: Rusia sapo kishte filluar sulmin me bombardime ndaj shtetit sovran të Ukrainës. Prandaj, si deputete e Parlamentit Shqiptar dhe si anëtare e Komisionit të Sigurisë Kombëtare dënoj me forcë sulmin e Rusisë ndaj Ukrainës. Duke iu rikthyer rendit të ditës, ne sot po diskutojmë projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Organizatën Hidrografike Ndërkombëtare. Në relacionin shoqërues argumentohet se anëtarësimi në Organizatën Hidrografike i shërben Shqipërisë, i shërben sigurisë në lundrimin detar, rrjedhimisht sigurisë detare, sigurisë së shtetit dhe të popullit shqiptar. Ne jemi anëtarë të këtij parlamenti, organi më i lartë përfaqësues, ndaj kemi të drejtën të pyesim, kemi detyrën të dyshojmë. Kemi të drejtën dhe detyrën që çështjen e sigurisë të mos e trajtojmë të izoluar vetëm në një propozim apo vetëm në një konventë, por ta trajtojmë të plotë, në të gjitha anët e mundshme, në të gjitha detajet e mundshme. Është fakt i ditur tashmë, sepse është informuar parlamenti, pra kanë dijeni edhe deputetët, se në këtë shtet, në këtë shtetin tonë problematik, dikur janë fikur radarët e kontrollit sa herë që kërkohej për të favorizuar trafikun e drogës. Këtë fakt e di i madh e i vogël, por deri më sot nuk dimë të ketë asnjë përgjegjës të vënë para drejtësisë. Pse po e risjell në vëmendje fikjen e radarëve? Jo për akuzë të rëndomtë e as për konsum ditor partiak. Po e risjell me qëllim që çështja e sigurisë të mos duket farsë, përrallë apo falsitet.

Mund të aderojmë në Konventën për Hidrografinë, e cila na paraqitet sot për votim, por nëse ky shtet s’ka përgjegjësi, s’ka seriozitet, s’ka vetëdije për detyrën kushtetuese, anëtarësimi ynë në këtë organizatë mund të rezultojë i pavlerë, pa asnjë produkt për shtetin, për popullin shqiptar e për sigurinë tonë të përbashkët. Në një pikë pajtohemi me relacionin: pa dyshim që siguria detare është e rëndësishme. S’ka asnjë dyshim që po. Sepse qëkur kur kanë lindur shtetet, gjithmonë është synuar deti, është kërkuar deti, është mbrojtur deti, sepse deti është mundësi e rëndësishme ekonomike për popujt. E kur e përfshijmë detin në planin e sigurisë kombëtare, ne si deputete të parlamentit kemi të drejtë edhe të pyesim. Pyesim në planin e përgjithshëm të sigurisë detare, meqenëse forca detare është pike kyçe e sigurisë në det: pse janë copëtuar bazat detare kryesore, konkretisht ato të Pashalimanit, Porto Palermos, Shëngjinit dhe të Kepit të Palit? Cila ka qenë arsyeja që pronat e bazave detare janë shkëputur nga bazat detare dhe janë bërë gati për t’iu dhënë klientëve të qeverisë?

Po ju sjell disa fakte: -Në janar të vitit 2016 është ngritur një grup pune për vlerësimin e pronave të Forcës Detare, kryesuar nga kolonel Ilir Xhebexhia. Ky grup pune përbëhej prej gjashtë anëtarësh dhe do të vlerësonte pikërisht pronat e katër bazave më të rëndësishme detare në Republikën e Shqipërisë: atë të Pashalimanit, të Porto Palermos, të Shëngjinit dhe Kepit të Palit. Në përfundim të punës së tij, grupi i famshëm i punës vendosi copëtimin e disa pronave të forcës detare, me qëllim nxjerrjen e tyre nga plani i përhapjes e i vendosjes dhe privatizimin e këtyre pronave, në kundërshtim të plotë me ligjin në fuqi, kryesisht me ligjin numër 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, si dhe me ligjin nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, të

ndryshuar". Pra, kjo skemë ishte totalisht e kundërligjshme. Dhe rezultati i copëtimit është si vijon: - Baza Detare e Pashalimanit, e cila ndodhet në Orikum, deri në vitin 2015 kishte 94 hektarë. Me propozim të qeverisë "Rama", i mbetën vetëm 14 hektarë, duke nxjerrë jashtë planit 80 hektarë. - Baza detare e Porto Palermos, deri në vitin 2015 kishte 28,8 hektarë dhe i mbetën vetëm 6,01 hektarë, duke i nxjerrë jashtë planit 22 hektarë. - Baza detare e Shëngjinit, deri në vitin 2015 kishte 6,59 hektarë, u copëtua dhe i mbetën vetëm 2,7 hektarë, duke i nxjerre jashtë planit 3,8 hektarë. - Baza Detare e Kepit të Palit kishte 72,4 hektarë, i mbetën rreth 27 hektarë, duke i nxjerrë jashtë planit 44 hektarë. Pra, këto katër baza detare, grupi famëkeq i punës, i ngritur prej Edi Ramës, nga 202,1 hektarë që kishin bazat detare, i copëtoi dhe i zvogëloi ato në 49,8 hektarë, duke u hequr në total 151 hektarë sipërfaqe. Pronave të mbetura brenda planit të përhapjes iu lanë edhe emri, edhe numri, edhe koordinatat gjeografike, ndërsa pronat jashtë këtij plani u lanë pa koordinata dhe me një VKM të vitit 2017 i kaloi në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes, duke u hapur rrugë kështu të gjithë klientëve qeveritarë që duan të përfitojnë nga pasuria publike.

Këtu lind pyetja: a është shqetësim për sigurinë kombëtare dhe për ne si deputetë të parlamentit shqiptar ky fenomen? Patjetër që është shqetësim shumë i madh, sepse ndodh që t'i hiqen pronat ushtrisë dhe kontrollit detar dhe t'u jepen klientëve qeveritarë, grupeve kriminale, që të pastrojnë paratë e drogës dhe të trafiqueve të tjera, duke ndërtuar hotele dhe resorte. Pra, bregdetit shqiptar i hiqen territore, ku kryhej dikur shërbimin ushtarët dhe u shtohen territoret grupeve kriminale për resortet e tyre, duke kontrolluar të gjithë territorin. Sikur këto prona të jepeshin për plazhe publike apo për turizëm natyror, do të ishte gjysma e së keqes. Pra, i gjithë shqetësimi ynë për këtë aferë korruptive është tek infiltrimi në shtet i elementit kriminal dhe klientelist, i cili, duke përdorur shtetin, merr nën kontroll pronat e ushtrisë dhe bazave detare për interesat e tyre. Infiltrimi i elementit kriminal brenda shtetit shqiptar na ka sjellë edhe tek afera e tanishme, tek ajo e inceneratorëve. Skandali kriminal i inceneratorëve, po ta trajtojmë në planin e sigurisë kombëtare, është pa dyshim kërcënim i hapur i sigurisë kombëtare. Është kërcënim i sigurisë, sepse në skandalin kriminal të inceneratorëve janë përfshirë ministra e ishministra, sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, kryetarët e bashkive dhe zyrtarë të tjerë të lartë, të cilët të koordinuar mjaft mirë me njëri-tjetrin kanë nxjerrë brenda ditës, madje brenda 8-orarëshit të punës, plot 17 vendime në funksion të kësaj afere korruptive pikërisht për të finalizuar vjedhjen e shekullit. Kodi Penal na e detajon shumë qartë se çfarë është bashkëpunimi në kryerjen e një veprë penale dhe çfarë është organizata kriminale, si forma më e lartë e bashkëpunimit, që dallohet nga shkalla e veçantë e organizimit, e strukturimit, qëndrueshmërisë, kohëzgjatjes, si dhe qëllimit për kryerjen e një apo më shumë veprave penale.

Pra, të dashur qytetarë shqiptarë, në rastin e inceneratorëve nuk kemi të bëjmë vetëm me një veprë të rëndomtë korupsioni, por kemi të bëjmë me një organizatë kriminale dhe një grup të mirëstrukturuar kriminal, me njerëz, të cilët janë mirëkoordinuar në marrëveshje të plotë me njëri-tjetrin për t'i vjedhur buxhetit të shtetit plot 430 milionë euro nga paratë e taksapaguesve shqiptarë. Organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal, të infiltruar brenda shtetit shqiptar, të katapultuar në poste publike të shtetit shqiptar, përbëjnë rrezik të lartë për ekonominë, për shtetin ligjor, rendin kushtetues, për informacionin e klasifikuar dhe sigurinë kombëtare në tërësi. Ndaj, si deputete e parlamentit shqiptar dhe si anëtare e Komisionit të Sigurisë, inkurajoj prokurorinë të hetojë në themel dhe në mënyrë të gjithanshme aferën korruptive e kriminale të inceneratorëve dhe t'i çojë përpara drejtësisë të gjithë pa dallim, nga i pari tek i fundit. Një hetim i tillë i shërben shtetit shqiptar dhe popullit shqiptar. Morali i fabulës për gjithçka sa përmenda më lart, meqenëse po flasim për anëtarësimin në Organizatën Hidrografike, është që aderimi i shtetit shqiptar në strukturat ndërkombëtare e rajonale të mos jetë thjesht për fasadë, thjesht fals dhe falsitet, por të ketë përfitime thelbësore, të jetë anëtarësim i vërtetë, në të kundërt anëtarësimi nuk ka asnjë vlerë. Ndaj për vetë

rëndësinë e këtij projektligji ne do ta votojmë pro aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën për Organizatën Hidrografike Ndërkombëtare. Ju faleminderit!